

MARRËVESHJE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date 29.03.2018, ne Tirane, palët e kësaj Marrëveshje Shitblerje Kuotash ("Marrëveshja"), ranë dakord si me poshtë vijon:

1. **Shoqëria IA Capital Sh.p.k.** një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar, themeluar ne përputhje me ligjin shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me Nr. Regjistrimi L72418016S, date 18.12.2017, me zyre qendrore te regjistruar ne adresën: Kashar Mezez, Lagja Mezes, Rruga "Kastriotet", Pallati Mehillaj nr. 3, Apartamenti 1. 1010, Tirane, Shqipëri, përfaqësuar rregullisht nga administratori Z. Ilir Bici, mbajtës i Kartës se Identitetit Nr. 031688291, ne cilësinë e Ortakut qe zotëron 1 kuote qe korrespondon me 49,23% te kapitalit te regjistruar te shoqërisë Planetar.Ent Sh.p.k.

Z. Ilir Bici, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 17/10/1979, mbajtës i kartës se identitetit me nr. 031688291 dhe numër personal H91017094O, banues ne adresën: Rruga "Bardhok Biba", allati nr. 75, apartamenti. 56, Tirane, Shqipëri, ne cilësinë e Ortakut qe zotëron 1 kuote qe korrespondon me 9,63% te kapitalit te regjistruar te shoqërisë Planetar.Ent Sh.p.k.;

Z. Erion Çoka, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 29/12/1979, mbajtës i kartës se identitetit me nr. 033375871 dhe numër personal H91229055O, banues ne adresën: Rruga "Mine Peza", pallati nr. 1, shkalla. 1, apartamenti. 1, Tirane, Shqipëri, ne cilësinë e Ortakut qe zotëron 1 kuote qe korrespondon me 31,54% te kapitalit te regjistruar te shoqërisë Planetar.Ent Sh.p.k.;

Z. Ramadan Bici, shtetas shqiptar, lindur ne Shënepremte, me 05/04/1955, mbajtës i kartës se identitetit me nr. 033107406 dhe numër personal F50405154G banues ne adresën: Lagja "Xhile Lici", ish çerdhja, Gramsh, Shqipëri, ne cilësinë e Ortakut qe zotëron 1 kuote qe korrespondon me 4,8% te kapitalit te regjistruar te shoqërisë Planetar.Ent Sh.p.k.;

Znj. Enida Rusi, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane, me 27/04/1982, mbajtëse e kartës se identitetit me nr. 024469266 dhe numër personal I25427061K, banues ne adresën: Rruga "Qemal Stafa", pallati nr. 12, apartamenti. 16, Tirane, Shqipëri, ne cilësinë e Ortakut qe zotëron 1 kuote qe korrespondon me 4,8% te kapitalit te regjistruar te shoqërisë Planetar.Ent Sh.p.k., së bashku më poshtë referuar si "**Shitësit**";

Dhe

2. **ABCOSM SHPK**, një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar, themeluar ne përputhje me ligjin shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me Nr. Regjistrimi K11308001B, date 17.04.1998, me zyre qendrore te regjistruar ne adresen: Rruga Reshit Çollaku (Pallati i Verdhë 6-katesh), Nd. 4, H. 2, Ap. 9, Tirane, Shqiperi, perfaqesuar rregullisht nga administratorët Z. Genti

Daci, mbajtës i Kartes se Identitetit Nr. H20625148U dhe Z. Altin Leksani, mbajtës i Kartes se Identitetit nr. H10506051E, me poshte referuar si "**Bleresi**";

Shitësit dhe Blerësi janë referuar me poshtë individualisht si "**Pala**" dhe se bashku si "**Palet**".

DEKLARATA PARAPRAKE:

- I. Shitësit janë pronare te 5 (pesë) kuotave që përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë "Planetar.Ent" Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar me numër Regjistrimi NUIS L81412012B, me date 12.02.2018 me seli ne adresën Rruga Selaudin Bekteshi, Godina nr. 3/5, kati i pare, Njësia Bashkiake nr. 8, Tirane, Shqipëri, kapitali i regjistruar i se cilës është i barabarte me 42,210,710 (dyzetë e dy milionë e dyqind e dhjetë mijë e shtatëqind e dhjetë) Leke ("**Shoqëria**");
- II. IA Capital zoteron 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 49,23% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise e barazvlefshme me 20.780.380 Leke Shqiptare; Z. Ilir Bicizoteron 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 9,63% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise e barazvlefshme me 4.064.880Leke Shqiptare; Z. Erion Çoka zoteron 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 31,54% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise e barazvlefshme me 13.313.230Leke Shqiptare; Z. Ramadan Bici zoteron 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 4,8% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise e barazvlefshme me 2.026.110 Leke Shqiptare; Znj. Enida Rusi zoteron 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 4,8% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise e barazvlefshme me 2.026.110 Leke Shqiptare.
- III. Shitesit deshirojne te shesin Kuotat e tyre tek Bleresi dhe Bleresi deshiron dhe pranon te bleje Kuotat nga Shitesi ("**Transaksioni**").
- IV. Palët kane nënshkruar me 29.03.2018 nje Kontrate per Shitblerje Kuotash, e cila parashikon kushtet dhe afatet per shitjen dhe blerjen e Kuotës ne Shitje ("**KSHK**") dhe vendosen te nënshkruajnë edhe këtë Marrëveshje per Shitblerje Kuotash, me qellim regjistrimin e transferimit te pronesise mbi Kuotat ne Shitje, pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit ("**QKB**").
- V. Me ane te Vendimit date 29 Mars 2018 te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise eshte miratuar kalimi i Kuotave ne Shitje nga Shitesit tek Bleresi dhe ne perputhje me Statutin e Shoqerise dhe sipas dispozitave te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar ("**Ligji Tregtar**"). Kuotat ne Shitje mund te transferohen pa pengese nga pronesia e Shitesve ne pronesine e Bleresit.

PER KETO ARSYE, Palet bien dakord si me poshte:

1. Shitesit i transferojne Bleresit 5 (pesë) Kuota ne Shitje, per nje cmim blerje i cili mund te arrije nje vlere maksimale te barabarte me 992.400 (nenteqind e nentedhjete e dy mije e katerqind Euro (“Cmimi i Blerjes”).
2. Ne Daten e Nenshkrimimit, me pagimin e Kestit te Pare ne vleren prej 347,340 (treqind e dyzet e shtate mije e treqind e dyzet) Euro, minus çdo rregullim i cmimit dhe tatimin mbi te ardhurat te mbajtur ne burim, kur eshte i zbatueshem ne perputhje me parashikimet e Ligjit nr. 8438, date 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, I ndryshuar, Shitesit do te transferojne 100% te titullit te pronesise mbi te 5 (pesë)Kuotat bashke me te gjitha te drejtat e tjera te votes dhe te drejtat e dividendit, dhe Bleresi do te fitoje titull te plote pronesie mbi Kuotat.
3. Bleresi pranon pronesine e Kuotave ne Shitje dhe pranon te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe lidhen me pronesine e Kuotave ne Shitje sipas parashikimeve te Statutit te Shoqerise dhe Ligjit Tregtar.
4. Shitesit dhe Bleresi bien dakord qe me kerkesen e pare te Pales tjetere dhe/ose Shoqerise, te nenshkruajne dhe te leshojne cdo dokument te nevojshem dhe ne pergjithesi te bejne cdo gje qe eshte e nevojshme qe transferimi i pronesise mbi Kuoten ne Shitje sipas kesaj Marreveshje te regjistrohet prane QKB-se, si edhe prane cdo autoriteti tjetere shqiptar, sipas ligjit.

Kjo Marreveshje u hartua ne 7 (shtatë) ekzemplarë origjinale me vlere te njejte ligjore, ne gjuhen shqipe. Marreveshja bazohet ne Nenin 705 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise dhe ne Ligjin Tregtar.

PALËT

SHITËSIT

ILIR BICI
Shoqëria IA Capital Sh.p.k.

ILIR BICI
Z. Ilir Bici



Erion Çoka

Z. Erion Çoka

Ramadan Bici

Z. Ramadan Bici

Enida Rusi

Znj. Enida Rusi

BLERËSI

ABCom SHPK

Përfaqësuar nga Administratoret:

Genti Daci

Z. Genti Daci



Altin Leksani

Z. Altin Leksani